

DOKUMENTACIONI PËR LEJE NDËRTIMI nga KKT
për shqyrtim paraprak në **Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit**
Sekretariati i Këshillit Kombëtar të Territorit

FAZA 1: DOSJA E APLIKIMIT PËR LEJE NDËRTIMI DUHET TË PËRMBAJË:

1. Kërkesë zyrtare e ministrit të linjës drejtuar Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT) për shqyrtim të lejes së ndërtimit nga Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT);
2. Opinioni tekniko-ligjor i ministrisë së linjës;

DOKUMENTACIONI LIGJOR

3. **Kontrata e Konçesionit** ose ratifikimi i Kontratës së Konçesionit në Parlament (nëse është e aplikueshme);
4. **Çertifikatë regjistrimi nga QKR** e kompanisë aplikuese;
5. **Licencat e projektuesve;**

TOKA/ TRUALLI

6. **Çertifikatë pronësie**, bashkëngjitur të cilës dhe kopja e kartelës shoqëruese nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (e marrë në tre muajt e fundit);
7. Nëse është tokë bujqësore, **vërtetim nga zyra e Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (DAMT)** nga Këshilli i Qarkut përkatës, për zërat kadastralë dhe kategorinë e tokës sipas bonitetit;
8. **Pranimi i kërkesës për shpronësim nga Ministria përkatëse**, shoqëruar me hartën e zonës së shpronësimit ose çertifikata pronësie për tokën ku do të kryhet zhvillimi (nëse ka shpronësim);
9. **Kontrata për dhënien në përdorim të fondit pyjor ose kullësor, me Drejtorinë e Fondit Pyjor** nëse studimi shtrihet në zonë pyjore, ose kontratë qeraje (nëse është e aplikueshme);
10. **Vendim i Këshillit Kombëtar të Ujit (KKU)** sipas dispozitave të ligjit 111/2012 datë 15.11.2012, "Për Menaxhimin e integruar të burimeve Ujore"(për rastin kur projekt-propozimi shtrihet pranë burimeve ujore);

TRASHËGIMIA KULTURORE

11. **Vërtetim i Institutit të Monumenteve të Kulturës** për prezencë ose jo të monumenteve në territorin ku aplikohet;
12. **Vendim i Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë (KKA) dhe Këshillit Kombëtar të Restaurimeve (KKR)**, (sipas dispozitave të legjislacionit të posaçëm sektorial, nëse është rasti për t'u aplikuar);
13. **Kontrata me Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik** për mbikqyrjen arkeologjike gjatë ndërtimit (ASHA), (sipas dispozitave të legjislacionit të posaçëm sektorial, nëse është rasti për t'u aplikuar);

MJEDISI

14. **Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis** (nga subjekt i liçencuar);
15. **Miratim për VNM paraprake/Leje / deklaratë ose pëlqim mjedisor** (sipas dispozitave ligjore në fuqi);

DOKUMENTACIONI TENIK

16. **Harta ku paraqitet plani i vendosjes së strukturës dhe parametrat urban**, në format A1 ose A0;
17. **Projekti/ materiali grafik përkatës** në formatin A3 (20-30 fletë), i cili ndër të tjera duhet të përmbajë:
 - 17.1 **Hartën e Infrastrukturës inxhinierike**, ku të tregohet gjendja ekzistuese e infrastrukturës në zonë dhe lidhja e strukturës që propozohet me të;
 - 17.2 Si pjesë e materialit grafik duhet të jenë edhe **imazhet 3D të objektit/eve** ku të lexohet arkitektura dhe impakti me kontekstin përreth (fotomontazh);
 - 17.3 **Koordinatat gjeografike** të projekt – propozimit në projeksionin UTM 34 N.
 - 17.4 projekti duhet të jetë në përputhje me:
 - **standardet për aksesueshmërinë nga persona me aftësi të kufizuar,**
 - **dispozitat e mbrojtjes kundër zjarrit.**
18. **Relacion teknik i projekt – propozimit** në format A4 (10-20 fletë);
19. **Grafiku i punimeve dhe organizimi i procesit të punës/plani i organizimit të punimeve;**
20. **Preventiv i realizimit të punimeve;**

21. **Raporti gjeologjik -inxhinierik – sizmik – hidrologjik;**
22. **Oponencë teknike** nga Instituti i Ndërtimit për projektin, nëse vlera e investimit e tejkalon shumë 100.000.000 (njëqind milionë lekë);
23. **Studimi i Fizibilitetit** për zhvillimin e propozuar/Plan biznesi (sipas rastit);
24. Shkresa për aplikim të shoqërohet me **CD të dokumentacionit ligjor dhe teknik** të listuar më sipër, **të skanuar nga origjinali.**

TË RËNDËSISHME:

- Dokumentacioni ligjor dhe Vërtetimet e Institucioneve do të dorëzohen në një **kopje origjinale ose fotokopje të noterizuar** pranë Ministrisë së linjës nga pala e interesuar;
- Dokumentacioni Teknik/ Materiali grafik do të dorëzohet pranë Ministrisë së linjës nga pala e interesuar, në një **kopje origjinale të firmosur nga projektuesit.**

BOTIMI NË REGJISTRIN E INTEGRUAR TË TERRITORIT:

- Në bazë të nenit 56, të Ligjit 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, materiali i mësipërm duhet të botohet në Regjistrin e Integruar të Territorit nga Ministria e linjës, si autoritet kombëtar i planifikimit të territorit, i cili **ka detyrim ligjor botimin e të gjitha projektakteve dhe akteve nga momenti i depozitimit të kërkesës e deri në miratimin përfundimtar të saj.**

FAZA 2: PËR PREZANTIM NË KKT: SUBJEKTI APLIKUES DUHET TË PËRGATISË SIPAS UDHËZIMEVE TË AKPT:

1. **Relacion teknik** i përmbledhur, në format A4 (3-6 fletë);
2. **Harta ilustruese të projekt – propozimit** dhe pamje 3 dimensionale (sipas rastit), në format A3 (1-3 fletë);
3. **Harta e Planvendosjes së Strukturës së projekt-propozimit** në formatin final të miratimit/zbardhjes (sipas formatit të përcaktuar nga AKPT);
4. **Prezantimi në PPT** të projekt – propozimit .

Materiali i përgatitur për prezantim në KKT do të dorëzohet pranë AKPT-së nga subjekti aplikues, vetëm pasi AKPT të njoftojë aplikuesin zyrtarisht për përputhshmërinë e projekt-propozimit me instrumentat e planifikimit në fuqi dhe Ligjin 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, dhe përcaktimit të datës së mbledhjes së KKT-së.

FAZA 3: PAS MIRATIMIT NË KKT: SUBJEKTI APLIKUES DUHET TË PËRGATISË SIPAS UDHËZIMEVE TË AKPT:

1. **Dokumenti i Rregullores** për zbatimin e Lejes së Ndërtimit (Sipas strukturës së përcaktuar nga AKPT), në 6 kopje;
2. **Harta e Planvendosjes së Strukturës së projekt-propozimit** në formatin final të miratimit (sipas formatit të përcaktuar nga AKPT), në 6 kopje.

✓ ***Plotësimi i pikave të mësipërme (1-24) është kusht i domosdoshëm që aplikimi të përcillet për shqyrtim dhe miratim në Këshillin Kombëtar të Territorit.***